

INTERVISTA

Banka e Bashkuar e Shqipërisë fillon një epokë të re të “rebranding”, rimodelimit dhe rienergizimit të biznesit

Ne dëshirojmë të jemi flamurtarë të nismës së Kombeve të Bashkuara për institucionet financiare, që synon të përmirësojë cilësinë e jetës së njerëzve, pa kompromentuar atë të brezave të ardhshëm.



Amel KOVAČEVIĆ

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË

Kohët e fundit jeni emëruar Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv (CEO) i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA). Cilat janë sfidat kryesore për këtë pozicion, në kushtet aktuale dhe ato në vijim, brenda sektorit bankar dhe sistemit financiar shqiptar?

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) është një bankë me traditë të gjatë në tregun shqiptar, por shërbimet e saj, pozicioni në treg dhe prania e saj duhet të përmirësohen dukshëm. Situata e përgjithshme e pandemisë e bëri rrugëtimin e UBA-s edhe më sfidues. Të qenit një institucion i vogël bankar në treg të jep mundësi për një përtëritje të shpejtë. Veprimtaria më e rëndësishme për bankën është të kuptojë atë çka po

ndodh në ekonominë shqiptare dhe të identifikojë prirjet dhe problemet, në mënyrë që të tërheqë klientë të rinj, nëpërmjet zgjidhjeve financiare që plotësojnë nevojat e tyre dhe sipas nivelit të dëshiruar të përvojës së klientit. Roli i drejtimit është të projektojë në mënyrë të qartë vizionin e biznesit, që do të jetë dhe qëllimi ynë përfundimtar në vitet që vijnë. Personalisht, besoj se jemi në fillimet e një epoke të re, që do ta çojë UBA-n drejt suksesit. Aksionarët tanë, drejtimi i bankës dhe punonjësit tanë janë të vendosur ta përdorin këtë mundësi unike për të shkëlqyer përsëri, përballë klientëve tanë të çmuar. Duke qenë një bankë që përpiqet të operojë në përputhje me parimet e bankut islamik, ne kemi përgjegjësinë të kujdesemi për nevojat e klientëve nga të gjitha sferat e jetës, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre, në mënyrë që të kanalizojmë burimet financiare në sektorë dhe projekte që do të përmirësojnë qëndrueshmërinë ekologjike, përfshirjen sociale dhe përparimin e përgjithshëm në Shqipëri.

Përtej sfidës së pandemisë COVID-19, cilat janë disa prej prioriteteve dhe objektivave që Banka e Bashkuar e Shqipërisë synon të realizojë nën drejtimin tuaj?

Ne kemi filluar një transformim gjithëpërfshirës të produkteve, procedurave dhe proceseve

bankare, të strukturës organizative dhe teknologjisë që do të fuqizojë bankën, rritin tonë të degëve dhe ndërveprimin me klientët, përfshirë këtu dhe procesin e “rebranding”. Nuk ekziston ndonjë shkop magjik që do të na çojë në nivelet e dëshiruara të suksesit të biznesit, por po bëhet një punë e zgjuar dhe e palodhur me hapa të vegjël, por të rëndësishëm, që do na çojë drejt destinacionit tonë të dëshiruar. Ne nuk duam të kopjojmë, ose të ndjekim ndonjë nga lojtarët e mëdhenj bankarë në treg, por duam të shfrytëzojmë mundësitë që vijnë nga prirjet e mëdha, të tilla si: ndryshimet teknologjike, demografike dhe të sjelljes konsumatore, si dhe veçoritë dhe problemet ekonomike të vendit, që mund të synojmë t’i japim zgjidhje.

Pandemia Covid-19 po na lejon të “pastrojmë dhe rimodelojmë” shtëpinë tonë më shpejt, sepse biznesi po ecën më ngadalë se zakonisht. Sidoqoftë, planet tona janë mjaft agresive dhe ne shpresojmë t’i arrijmë ato në 2021-shin.

Si e vlerësoni ju pozicionimin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë në sektorin bankar shqiptar dhe në sistemin financiar, lidhur me produktet dhe shërbimet bankare?

Gama e produkteve dhe shërbimeve të UBA-s po përmirësohet shumë shpejt dhe ne shpresojmë të kemi një ofertë

tërheqëse dhe të përshtatshme për klientët e rinj, gjatë muajve në vijim. Ne do të dëshironim të njiheshim nga tregu për përvojën digjitale, aftësinë për të plotësuar menjëherë nevojat gjithnjë në ndryshim të klientit, por kryesisht dëshirojmë të identifikohemi si ofrues i shërbimeve financiare, në përputhje me sistemin tonë të besimit.

Në planin afatshkurtër, fokusi ynë është përmirësimi i shërbimeve bankare tradicionale dhe kanaleve të shpërndarjes. Ne kemi realizuar praninë e mbajtësve të kartave tona në rrjetin prej më shumë se 700 ATM në Shqipëri, pa asnjë kosto transaksioni për ta. Ne dëshirojmë të shfrytëzojmë infrastrukturën bankare ekzistuese dhe nuk

mendojmë të shpenzojmë kohë dhe fonde për të njëjtat burime, që ekzistojnë tashmë. Sidoqoftë, ne preferojmë të investojmë në partneritete strategjike dhe ekosisteme, të cilat mund të sigurojnë vlerë të shtuar në treg, avantazh konkurrues dhe hapësirë për rritjen e biznesit të bankës.

Në planin afatgjatë, ne dëshirojmë të eksperimentojmë raste jo-konvencionale biznesi, të cilave nuk u është shërbyer ende financiarisht dhe teknologjikisht në Shqipëri, pasi besojmë se brezat e ardhshëm e kuptojnë bankën dhe presin nga bankat shërbime krejtësisht të ndryshme nga ato që kemi bërë ne, ose prindërit tanë në të kaluarën. Një synim tjetër afatgjatë i UBA-s

është lidhja e sektorit të korporatave shqiptare me tregje fitimprurëse, ku institucionet financiare islamike janë krijuar tregu.

Si një bankë që po përpiqet të veprojë në përputhje me parimet bankare islamike, ne kemi përgjegjësi të madhe në zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve bankare islamike, të ofruara në tregun shqiptar, në mënyrë që t'i shërbejmë më mirë klientëve tanë. Për më tepër, edhe pse jemi lojtar i vogël në treg, ne dëshirojmë të jemi flamurtarë të nismës së Kombeve të Bashkuara për institucionet financiare, që synon të përmirësojë cilësinë e jetës së njerëzve, pa kompromentuar atë të brezave të ardhshëm.

